

URDHËRESË
Nr.4, datë 25.5.1990

PËR SHPËRNDARJEN DHE SISTEMIMIN E PUNËTORËVE

Me qëllim që burimet e punës të studiohen dhe të shpërndahen derjt e me kritere, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Burimet e punës llogariten, studiohen e shpërndahen sipas metodologjisë së planifikimit të ekonomisë e të kulturës dhe metodikës përkatëse. Për këtë hartohet bilanci i burimeve dhe i shpërndarjes së krahëve të punës. Në shkallë rrethi ky bilanc hartohet nga seksioni i punës dhe, pasi miratohet nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, i dërgohet Komisionit të Planit të shtetit, së bashku me treguesit e tjerë të projektplanit, kurse për gjithë vendin hartohet nga Komisioni i Planit të shtetit.

Neni 2

Burimet e punës të pashpërnadra dhe ato që krijohen të reja në qytete, në qendra të banuara jashtë qytetit dhe në teritorin e ndërmarrjeve bujqësore, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe të rajoneve për Tiranën i shpërndajnë në vendet e punës që krijohen në ndërmarrje, institucione të ndryshme e repartet ushtarake, në qytet e jashtë tyre, si dhe në kooperativa bujqësore.

Neni 3

Burimet e reja të punës që krijohen në fshatrat që janë kooperativa bujqësore, sistemohen me punë në kooperativë bujqësore.

Me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, pasi të jenë përdorur të gjitha burimet e punës të pashpërndara dhe ato që krijohen të reja në qytete, qendra të banuara jashtë qytetit dhe në teritorin e ndërmarrjeve bujqësore, muhdt të tërhiqen punëtorë nga fshatrat që janë kooperativë bujqësore, për nevoja tepër të domosdoshme të ndërmarrjeve minerare, të naftës, të gjeologjisë, të shfrytëzimit e të përpunimit të drurit, të pyjeve, të ndërtimit, të bonifikimit e ndonjë tjetër.

Neni 4

Ndërmarrjet, insitucionet, repartet ushtarake dhe kooperativat bujqësore, për veprimtarinë që ushtrojnë brenda rrethit, sipas afateve të përcaktuara në metodologjinë e planifikimit, i paraqesin komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe të rajonit nevojat e reja për punëtorë për vitin pasardhës, ndarë në tremujorë, në meshkuj e femra, sipas profesionit e punës jashtë qyteteve ose në fshat, si dhe numrin e punëtorëve me vendbanim në fshatrat që janë kooperativë bujqësore, ndarë për çdo kooperativë bujqësore, për të cilët kërkohet përsëritja e marrëveshjes. Për veprimtarinë që ushtrojnë jashtë rrethit, nevojat për punëtorë të rinj për vitin pasardhës ua dërgojnë sektorëve të tyre në rrethet e tjera, të cilat ia paraqesin ato komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit përkatës dhe të rajonit për Tiranën.

Neni 5

Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit dhe i rajonit për Tiranën, në përputhje me kërkesat e bëra për punëtorë të rinj nga çdo ndërmarrje, institucion, repart ushtarak ose kooperativë bujqësore, përcakton burimet e sigurimit të tyre për veprimtarinë që këto ushtrojnë brenda rrethit dhe për Tiranën brenda rajonit. Për këtë, brenda afateve të përcaktuara në metodologjinë e planifikimit, për vitin pasardhës u dërgojnë:

a) Ndërmarrjeve, institucioneve, reparteve ushtarke dhe kooperativave bujqësore, numrin e punëtorëve të rinj që do të marrin gjatë vitit, ndarë në tremujorë, në meshkuj e femra, vendin nga do të tërhiqen, nga cila lagje e qyteit ose qytet që nuk ka lagje, dhe nga cili fshat.

b) Këshillave popullorë të lagjeve të qyteteve, këshillave popullorë të qyteteve që nuk kanë lagje, dhe këshillave popullorë të fshatrave numrin e punëtorëve të rinj për çdo ndërmarrje, institucion, repart ushtarak e kooperativë bujqësore, si dhe numrin e punëtorëve që do të dërgohen në kurse kualifikimi, si vjetor, ndarë në tremujorë, në meshkuj e femra, si dhe numrin e punëtorëve me banim në fshatra që janë kooperativë bujqësore, për të cilët do të përsëritet marrëveshja për vitin pasardhës.

Komitetit ekzekutiv të këshillave popullorë të rajoneve të Tiranës i dërgojnë treguesit e mësipërm pasi t'i kenë bashkërenduar në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Nevojat për punëtorë të rinj që u dalin ndërmarrjeve, institucioneve, institucioneve e reparteve ushtarake gjatë zbatimit të planit, si rregull, sigurohen nga vetë rajoni përkatës dhe për rastet kur rajoni me burimet e punës që ka nuk përballon të gjitha kërkesat sipas seksit, profesionit, nivelit arsimor etj., bëhet bashkërendimi me komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit i cili u vë detyrë rajoneve të tjera.

Neni 6

Këshilli popullor i fshatit, sipas planit të dërguar nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit dhe të rajonit për Tiranën, cakton personat që me pëlqimin e tyre dërgohen për të punuar në ndërmarrje, institucione e në reparte ushtarake dhe në kurse kualifikimi, pa u shpërngulur familja e tyre nga fshati, si dhe emëron ose jep fletëpranimin për punë për punëtorët e shërbimit të institucioneve shëndetësore, arsimore, kulturore, të shërbimit komunal dhe të rrjetit të tregtisë, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të juridiksionit të tij.

Neni 7

Për punëtorët që do të tërhiqen nga fshatrat që janë kooperativë bujqësore e që do të jenë në marrëdhënie pune në sektorin shtetëror, ndërmjet kryesisë së kooperativës bujqësore dhe drejtorisë së ndërmarrjes, institucionet ose repartit ushtarak lidhet marrëveshje me shkrim me afat deri në tre vjet. Në marrëveshje përcaktohet numri i punëtorëve dhe koha e qëndrimit në punë të tyre në ndërmarrje, institucion ose repart ushtarak. Kësaj marrëveshjeje i bashkëngjiten listat emërore të punëtorëve për çdo fshat, të miratuara nga këshilli popullor i fshatit përkatës. Marrëveshja e punës, pas mbarimit të afatit të caktuar, mund të përsëritet memirativ të seksionit të punës të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Neni 8

Rrethet që kanë më tepër krahë pune, mund t'i dërgojnë me pëlqimin e punëtorëve prë të punuar në rrethet që kanë nevojë për krahë pune, kur bien dakord me njëri tjetrin.

Dërgimi i punëtorëve nga njëri rreth në tjetrin për të punuar në veprat e mëdha e me rëndësi kombëtare bëhet kurdoherë në bazë të planit të dërguar nga Komisioni i Planit të Shtetit.

Neni 9

Veprimtaritë që ndërmarrjet, institucionet e repartet ushtarake kërkojnë t'i kryejnë me kooperativat bujqësore, kur është e pamundur për t'u kryer me punëtorë nga qyteti, parashikohen në planin ekonomiko-financiar të ndërmarrjes, institucionit, repartit ushtarak dhe kooperativës bujqësore. Në këtë rast merret më parë miratimi i seksionit të bujqësisë dhe i seksionit të punës në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe të rajonit për Tiranën, si dhe lidhet marrëveshje ndërmjet ndërmarrjes, institucionit, repartit ushtarak dhe kooperativës bujqësore.

Neni 10

Shtetasit e aftë për punë me banim në qytete, në territorin e ndërmarrjeve bujqësore ose në

qendra të tjera të banuara që kërkojnë punë për herë të parë, ose ata që janë larguar nga puna dhe kërkojnë të sistemohen në një qendër tjetër pune, regjistrohen përkatësisht në këshillin popullor të lagjes, në këshillin popullor ose në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit që nuk ka lagje, si dhe në këshillin popullor të fshatit. Këta, sipas ndarjes së bërë e të dërguar nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit e të rajonit për Tiranën, japin fletëpranim për punë, duke pasur parasysh kushtet dhe aftësitë e shtetasve.

Neni 11

Kur veprimtaria prodhuese e ndërmarrjes ndërpritet për shkak të përsëritjes së humbjeve të paplanifikuara, punëtorët sistemohen me punë në ndërmarrje e sektorë të tjerë nëpërmjet seksionit përkatës dhe seksionit të punës në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe të rajonit për Tiranën.

Neni 12

Punëtorët që janë në marrëdhënie pune dhe dërgohen për të punuar në veprat e mëdha e me rëndësi kombëtare ose në ndërmarrjet e rretheve të tjera për një afat të caktuar, pas mbarimit të afatit, rikthehen në qendrën e punës ku kanë punuar më parë. Në këtë rast pranimi i tyre në punë bëhet në bazë të autorizimit që lëshon seksioni i punës i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe të rajonit për Tiranën.

Neni 13

Kur ka ndërprerje të përkohshme në punë dhe administrata e ndërmarrjes, e institucionit dhe e repartit ushtarak u siguron punë punëtorëve në një ndërmarrje tjetër, pranimi në punë i këtyre punëtorëve bëhet në marrëveshje ndërmjet dy ndërmarrjeve, Në marrëveshje përcaktohen detyrimet e ndërmarrjeve, si dhe afati i qëndrimit të punëtorëve në punë. Në këtë rast fletëpranimin për punë e zëvendëson lista emërire e punëtorëve, kurse librezat e punës për të bërë shënimet e nevojshme paraqiten nga dega ekuadrit e ndërmarrjeve, institucioneve ose reparteve ushtarake përkatëse.

Neni 14

Pranimi në punë i punëtorit të dënuar me riedukim nëpërmjet punës, si dhe i punëtorit që është caktuar nga administrata e ndërmarrjes, institucionit dhe e repartit ushtarak për të punuar në një punë që paguhet më pak deri në 6 muaj në një qendër pune tjetër brenda rrethit, bëhet në bazë të autorizimit që lëshon seksioni i punës i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit e të rajonit për Tiranën.

Neni 15

Në bazë të dispozitave të kësaj urdhërese, sistemohen në punë gjithë shtetasit e aftë për punë që sipas udhëzimeve të veçanta konsiderohen e trajtohen si punëtor, nxënësit që shkojnë në shkollat e ulta profesionale, në kurse kualifikimi e nxënësit në ekonomi, si dhe nënoficerët aktivë dhe policit.

Neni 16

Nxënësit që mbarojnë shkaollat e mesme profesionale me shkëputje nga puna dhe që do të sistemohen në punë si punëtorë, fillimisht spërndahen dhe sistemohen në punë nga seksioni i punës, në bashkëpunim me seksionet e tjera përkatëse të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Për Tiranën, seksioni i punës në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit bën shpërndarjen sipas rajoneve dhe seksionet e punës në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rajoneve bëjnë shpërndarjen për çdo ndërmarrje, institucion, repart ushtarak e kooperativë bujqësore, që ushtrojnë veprimtarinë brenda juridiksionit të tyre. Pastaj edhe për këta zbatohen dispozitat e kësaj urdhërese, njëjloj si për gjithë punëtorët e tjerë.

Të rinjtë që mbarojnë shërbimin e detyruar ushtarak dhe që kanë qenë në marrëdhënie pune, si rregull, sistemohen në qendrat e punës ku kanë punuar më parë, kur këto kanë kërkesë për punëtorë të rinj. Në këtë rast pranimi i tyre në punë bëhet në bazë të fletëpranimit për punë të lëshuar nga këshilli popullor i lagjes, këshilli popullor i qytetit që nuk ka lagje, dhe këshilli popullor i fshatit.

Neni 17

Shtetasit që banojnë në qytete, në territorin e ndërmarrjeve bujqësore ose në qendra të tjera të banuara, për t'u vendosur në punë paraqesin fletëpranimin për punë dhe librezën e punës.

Shtetasit që banojnë në fshatrat që janë kooperativë bujqësore e që janë caktuar të punojnë si punëtorë në institucione shëndetësore, arsimore, kulturore, të shërbimit komunal ose në rrjetin e tregtisë, për t'u vendosur në punë paraqesin librezën e punës dhe fletëpranimin për punë të lëshuar nga këshilli popullor i fshatit. Kur këta shtetas janë caktuar të punojnë me marrëveshje në ndërmarrje, institucione ose reparte ushtarake, fletëpranimin për punë e zëvendëson lista emërore e miratuar nga këshilli popullor i fshatit, që i bashkëngjitet marrëveshjes.

Shtetasit që kanë vendbanimin në një rreth tjetër dhe që merren në punë në bazë të marrëveshjes ndërmjet dy rretheve, ose në bazë të urdhërit të titullarit të ministrisë e të institucionit tjetër qendror, paraqesin librezën e punës dhe autorizimin me shkrim të lëshuar nga seksioni i punës në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ku merren në punë, ose urdhrin përkatës të ministrisë a të institucionit tjetër qendror.

Kur shtetasi hyn për herë të parë në punë, në vend të librezës së punës, paraqet një vërtetim të lëshuar nga organi që e ka pajisur me fletëpranimin për punë, me anën e të cilit vërtetohet se ai nuk ka qenë më parë në marrëdhënie pune.

Neni 18

Shtetasi pranohet më punë nga personi zyrtar i qendrës së punës i ngarkuar me këtë detyrë.

Personi zyrtar që merr, mban në punë punëtorë ose jep fletëpranimi për punë nëkundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese, si dhe ai që nuk pranon në punë punëtorin që është pajisur me fletëpranimin për punë sipas rregullave të caktuara nga organet kompetente, kur shkelja nuk formon vepër penale, dënohet me qortim shoqëror ose me gjobë për çdo rast gjer në 500 lekë.

Dënimi jepet nga punonjësit e seksionit të punës në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit dhe të rajonit për Tiranën për ndërmarrjet, institucionet, repartet ushtarake dhe kooperativat bujqësore që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të juriidksionit të tyre. Këtë të drejtë e kanë edhe punonjësit e Drejtorisë së treguesve të punës dhe të zënies me punë të Komisionit të Planit të Shtetit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda pesë ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht, te kryetari i komitetit ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, të rajonit për Tiranën, dhe te kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 19

Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 2.8.1985 "Për shpërndarjen dhe sistemimin e punëtorëve", shfuqizohet.

Neni 20

Kjo urdhëresë hyn në fuqi më 1.7.1990

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI